



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Rasti i përfutimit të kontrollit të përbashkët i shoqërisë Assist Digital S.p.A. nga shoqëria Freedom 1 S.r.l. dhe persona fizikë.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 58 prot. i AK, datë 20.01.2023 “Përqendrimi nëpërmjet fitimit të kontrollit të Assist Digital S.p.A. nga shoqëria Freedom 1 S.r.l., Enrico Donati, Francesca Gabrielli, Franco Fradiani, Manlio Costantini, – Njoftim në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me përfutimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Assist Digital S.p.A. nga shoqëria Freedom 1 S.r.l. dhe disa persona fizikë.

Referuar dokumentit “Marrëveshje e shitjes dhe blerjes së aksioneve”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Freedom 1 S.r.l. (TopCo) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit italian dhe një filial i fondit të investimeve Ardian Expansion V Fund, i administruar nga Ardian France SA dhe bën pjesë në Grupin Ardian. Ardian France SA është një shoqëri private e administrimit të fondeve private të kapitalit që, nëpërmjet grupit të saj, kryen aktivitete investimi në Evropë, Amerikën e Veriut dhe Azi.

Grupi Ardian është prezent dhe realizon xhiro në Shqipëri përmes disa filialeve të kompanive të zotëruara prej tij si: F2A Tirana Branch, ASAF Tirana Branch dhe JAKALA LAB SHPK (e çregjistruar).

Wide Open S.r.l është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit italian, e cila zotëron aksione të shoqërisë target Assisist Digital S.p.A.

Dreamers Società Semplice është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit italian, regjistruar në Regjistrin e Shoqërive në Milano-Monza-Brianza-Lodi, e cila zotëron aksione të shoqërisë target Assisist Digital S.p.A.

Personat fizik; Z. Enrico Donati, Zj. Francesca Gabrielli, Z. Franco Fradiani, Z. Manlio Costantini.

Shoqëria Target: Assisist Digital S.p.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit italian, aktiv në ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të klientit.

Targeti operon në Shqipëri nëpërmjet filialit të zotëruar plotësisht prej tij **Assist SHPK**, me objekt aktiviteti: studimin, konsulencën, projektimin, realizimin dhe shërbimet e menaxhimit për shoqëritë dhe ente drejtuese, për të mbështetur shitjen e mallrave ose kryerjen e shërbimeve të vetë klientit; ofrimin e shërbimeve call center, data-center, front-line, për të mbështetur bizneset dhe ndërmarrjet në proceset e kontaktit me klientët e tyre; realizimi dhe menaxhimi i rrjeteve të informatikës dhe telekomunikacionit për shërbime globale dhe/ose lokale; projektim, prodhim dhe instalim të sistemeve informatike për kontrollin e menaxhimit të enteve dhe institucioneve publike dhe private, për planifikimin dhe kontrollin ekonomik të ndërmarrjeve etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.